



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 122, Datë 08.08.2017

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s ME NR. 75, DATE 26.05.2017 “PËR NJË NDYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 25, DATË 15.02.2017 “MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR.169 DATË 31.10.2016 “MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE NR. 103 DATË 23.06.2016, “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, gërma “1”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës __.08.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.75, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e një ndryshimi në pikën 2 të Vendimit të Bordit të ERE-s nr.169, datë 31.10.2016 “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në Vendimin e ERE-s Nr.103, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

Konstatoi se:

1. Mbështetur në nenin 19 gërma “1” ERE miraton, me propozim të të licencuarve rregullat për: i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik,
2. OSHEE sha, gjithashtu në shkresën me Nr. 19110 Prot, datë 04.08.2017 ka kërkuar shtyrjen e Vendimit të Bordit të ERE-s me Nr. 75, date 26,05.2017, me 60 ditë .

3. OSHEE sh.a. bën me dije se grupi i punës i ngritur nga OSHEE sha, ka filluar punën me qëllim krijimin e platformës online për prokurim/blerjen online të energjisë elektrike dhe është hapur procedura me objekt “ ndërtimi i platformës elektronike të publikimit të të dhënave të blerësit dhe shitësit në funksion të blerjes/shitjes së energjisë elektrike.
4. Oshee sqaron se, duke marrë parasysh afatet ligjore që parashikon ligji i prokurimit publik “.... *autoriteti kontraktor fton operatorin ekonomik të shpallur fitues që të lidhë kontratën jo më vonë se 60 ditë nga data e publikimit” si dhe të depozitojë dokumentat standarte të tenderit ku kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor i ekzekutimit është 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.*
5. ERE ka nisur më herët procedurat për shqyrtimin e disa ndryshimeve në Vendimin e ERE Nr. 103 datë 23.06.2016, dhe është ende në fazën e shqyrtimit të tyre.

Për gjithë sa më sipër: Bordi i ERE

Vendosi:

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 1 të vendimit të Bordit të ERE Nr. 75, Datë 26.05.2017 si më poshtë :
Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.103, date 23.06.2016, hyn në fuqi brenda datës 30.09.2017.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.122, Datë 08.08.2017

MBI

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s ME NR. 75, DATE 26.05.2017 “PËR NJË NDYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 25, DATË 15.02.2017 “MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR.169 DATË 31.10.2016 “MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE NR. 103 DATË 23.06.2016, “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Abaz Aliko

Entela Shehaj
